



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:113485
Datë: 12.11.2024
Numri i dokumentit: 06440398

PML.nr.679/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar, Valdete Daka dhe Rasim Rasimi, anëtarë me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit S.D., nga fshati P., komuna e Gj., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.6 dhe par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtëses së të dënuarit, ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan -Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.427/2023 datë 06.07.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.785/2024 datë 27.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 7 nëntor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET, si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtëses së të dënuarit S. D., ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm,P.nr.427/2023 të datës 06.07.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, PA1.nr.785/2024 të datës 27.06.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.427/2023 të datës 06.07.2023, dënuari S. D., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-së, dhe i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 20.05.2023

e deri me datën 06.07.2023. Të dënuarit i është shqiptuar edhe dënimi plotësues ndalimi i drejtimit të automjetit në periudhë prej një (1) viti, e pas mbajtjes së dënimit.

I dënuari është obliguar që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € si dhe shpenzimet e procedurës penale, për ekspertizë 124 € si dhe 20 € në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest të rregullt juridik.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin, PA1.nr.785/2024 e datës 27.06.2024, ka refuzuar ankesat e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe mbrojtëses së të dënuarit, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësja e të dënuarit, avokatja Shqipe Ramushi, nga Gj., me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim si dhe të shtyhet apo të ndërpritet ekzekutimi i vendimit të formës së prerë.

Prokuroria e Shtetit të Kosovës, me parashtresën KMLP.II.nr.392/2024 e datës 04.11.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e ushtruar nga mbrojtësja e të dënuarit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është e pabazuar.

Në kërkesë, mbrojtësja e të dënuarit, avokatja Shqipe Ramushi, pretendon se aktgjykimet janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor e të cilat shkelje kanë të bëjnë me shkelje nga neni 384 par.2, nënpar.2.1 të KPP-së, pasi që aktgjykimi i shkallës së parë nuk është përpiluar në pajtim me nenin 369 të KPP-së dhe në kundërshtim me par.7 të dispozitës së cekur. Kjo nga fakti se në aktgjykimin e saj, gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë faktet të cilat i ka konsideruar si të vërtetuara sidomos nga fakti se nuk janë vlerësuar drejtë rrethanat lehtësuese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Ndërsa, gjykata e shkallës së dytë, edhe pse i ka pas raportet e ekspertëve psikiatër dhe oftamolog, nga të cilat dëshmohet se i dënuari e ka gjendjen e rëndë shëndetësore e sidomos se ka pamjen e dëmtuar në

shkallë prej 95%, nuk i ka marrë parasysh këto fakte dhe rrethana të reja dhe nuk i ka administruar e as nuk ka vendosur lidhur me to.

Gjykata Supreme, duke vlerësuar pretendimet nga kërkesa si dhe bazuar në shkresat e çështjes gjen se aktgjykimet nuk janë të janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Kështu, dispozitivet e aktgjykimeve janë të qarta, konkrete dhe nuk përmbajnë kundërthënie qoftë me vetveten, qoftë me arsyetimin e tyre. Në arsyetimin e aktgjyimit të shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo gjykatë. Ndërsa, duhet të theksohet se i dënuari në prani të mbrojtëses dhe pas këshillimit me të njëjtën, në shqyrtim fillestar, ka pranuar fajësinë lidhur me akuzën e cila i është lexuar, dhe të cilën i dënuari ka deklaruar se e kupton dhe se pranon fajësinë për veprën penale me të cilën e ka ngarkuar. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë, pasi që është bindur se janë plotësuar kushtet ligjore për një pranim të tillë dhe se pranimi ka mbështetje në provat dhe faktet të cilat i përmban akuza e ka aprovuar një pranim të tillë.

Gjykata e shkallës së parë, ka dhënë arsye për të gjitha faktet relevante, ndërsa duhet të theksohet se kur gjykata aprovon pranimin e fajësisë, arsyetimi nuk bënë vlerësimin e provave, pasi që të njëjtat nuk administrohen dhe jep arsye vetëm lidhur me llojit dhe lartësinë e dënimit.

Sa i përket pretendimeve se gjykata e shkallës ë dytë edhe pse i ka pas raportet e ekspertëve psikiatër dhe oftamolog, nga të cilat dëshmohej se i dënuari e ka gjendjen e rëndë shëndetësore e sidomos se ka pamjen e dëmtuar në shkallë prej 95%, nuk i ka marrë parasysh këto fakte dhe rrethana të reja dhe nuk i ka administruar e as nuk ka vendosur lidhur me to, kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së dytë nuk administron prova të reja në seancën e kolegjit sipas ankesës, por vetëm shqyrton ankesën. Në rastin konkret, të dy gjykatat kanë dhënë arsye të mjaftueshme ligjore dhe faktike lidhur me shqiptimin e dënimit e sidomos janë vlerësuar të gjitha rrethanat qoftë rëndësuese qoftë lehtësuese të cilat janë marrë parasysh me rastin e matjes së dënimit, e të cilin arsyetim e pranon edhe kjo gjykatë si të drejtë e të ligjshëm, ndërsa duhet të theksohet se është në diskrecionin e gjykatës vlerësimi i rrethanave në çdo rast konkret, përveç kësaj janë dhënë arsye ligjore të cilat kanë ndikuar në shqiptimin e dënimit.

Nga të gjitha këto që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në mbështetje të dispozitës së nenit 437 të KPP-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
PML.nr.679/2024, më 7 nëntor 2024

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi